



### TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.63

Njësia e Vendosur në Tender Nr.22

Centrotekstil Lokali në Prishtinë

<b>Emri i NSh.-së</b>	Aseti Centrotekstil Import-Export (në likuidim)
<b>Lloji i shitjes</b>	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
<b>Dita e Ofertimit</b>	Më 18.10.2023 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
<b>Regjistrimi i Ofertuesit</b>	Nuk ka parakualifikim
<b>Depozita e Ofertës</b>	10,500 Euro
<b>Vendndodhja e Aseteve</b>	Rr.Agim Ramadani, nr.242 në Prishtinës <b>Njësia Centrotekstil Lokali në Prishtinë</b> - gjendet në qendër të qytetit, në kënd të dy të rrugëve më të frekuentuara të Prishtinës, rrugës Agim Ramadani dhe rrugës Tringë Smajli i cili ndodhet në përdhese të ndërtesës shumëkatëshe banesore –afariste. Lokali momentalisht është i ndarë në dy hapësira dhe ka sipërfaqe të përgjithshme në bazë të matjeve në teren (sipërfaqe të shfrytëzueshme) prej 57m <sup>2</sup> ,ndërsa sipas kontratës së shitblerjes ka një sipërfaqe prej 58.73 m <sup>2</sup> . Pronësia e lokalit dëshmohet në bazë të Kontratës mbi shitblerjen në mes të Odës Ekonomike të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Ndërmarrjes Centrotekstil -Import –Export si dhe dokumentit mbi marrëveshjen e ndërtimit të lokalit me nr. të protokollit 920 në mes Odës Ekonomike të Krahinës Autonome të Kosovës dhe BVI për Banim. Nuk ka toke qe do te transferohet tek blerësi i ri.
<b><u>Përshkrimi i Aseteve</u></b>	
<b>Ndërtesat dhe tokat</b>	
<b>Shfrytëzuesit</b>	Ekziston marrëveshja e qirasë me AKP-në e cila skadon me 30 prill 2024.
<b><u>Përshkrimi i Aseteve</u></b>	
<b>Asetet tjera</b>	Nuk ka.
<b>Detyrimet që do të barten</b>	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.

Foto/fotot  
Ose informata të tjera  
Për asetet në shitje



Legjenda  
Aseti Centrotextë ka një sipërfaqe prej 57 m<sup>2</sup>

AKP - ZR Prishtinë

Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.

## Raporti i vizitës në terren

Raporti i vizitës në teren është realizuar më 06 korrik 2023.  
Të bashkëlidhur keni raportin e vizitës në teren.

  
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Raport nga vizita në teren për Njësinë Centrotekstil Lokali në Prishtinë**

Data: 06.07.2023

Vizita e njësisë Centrotekstil Lokali në Prishtinë është bërë më 06.07.2023 ku prezent ishin zyrtarja Kadastrale Blerina Kukaj dhe zyrtarja për shitje Durime Perjuci.

Njësinë Centrotekstil Lokali në Prishtinë ndodhet në qendër të qytetit në rrugën "Agim Ramadani" nr.242 në Prishtinë. Lokali ndodhet në përdhese të ndërtesës shumëkatëshe banesore-afariste. Lokali momentalisht është i ndarë në dy hapësira dhe ka sipërfaqe të përgjithshme neto në baze të matjeve në terren (sipërfaqe të shfrytëzueshme) prej 57 m<sup>2</sup>, ndërsa sipas kontratës së shitblerjes ka një sipërfaqe 58.73m<sup>2</sup> bruto.

Nga vizita e lartcekur është konstatuar si në vijim:

- Hyrja në lokal bëhet direkt nga rruga Agim Ramadani.
- Lokali është ndarë në dy pjesë.
- Sipas matjeve në terren del se lokali ka një sipërfaqe prej 57 m<sup>2</sup>.

Të bashkëlidhur mund të gjeni orto-foton dhe skicën e lokalit.

Raportin e përgatitën:

 Blerina Kukaj Zyrtare Kadastrale, Zyra Rajonale Prishtinë Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)	 Durime Perjuci ZOAA- Zyra Rajonale Prishtinë Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
---	--

## Informatat

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët  
Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1090, 2059  
Fax: +381 (0) 38 248 076  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

## Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Rruga: Dritan Hoxha, nr.55  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovë.